



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Legjislacion, Mandate,

Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen

e Agjencisë Kundër Korrupsionit

Mbledhja nr. 44

Prishtinë, më 1.12.2015, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla S 2

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Selville Halimi, Armend Zemaj, Agim Aliu, Danush Ademi, Nezir Çoçaj, Doruntinë Maloku, Agim Ademaj dhe Milena Miliçević.

Munguan: Albulena Haxhiu, Donika Kadaj-Bujupi dhe Valdete Bajrami.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Floriana Merovci, ZPRK; Shefki Kastrati, NDI; Amire Qamili, BIRN; Alban Brajšhori dhe Taulant Osmani, Rrokum TV; Petrit Hysaj, OSBE; Blerta Bejtullahu, EUSR/EV Office; Kaltrina Ahemti, GLPS; Berat Thaçi, GAP; Mërgime Kajtazi, KDI dhe Norë Shabani, gazeta “Koha Ditore”.

Nga Staf i Komisionit: Visar Krasniqi, koordinator i Komisionit.

Mbledhjen e kryesoi, Selville Halimi, nënkryetare e Komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura më 30 tetor, 3 dhe 10 nëntor 2015;
3. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit funksional në Projektligjin nr. 05/L-58 për dizajnin industrial;
4. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit funksional në Projektligjin nr. 05/L-57 për themelimin e Fondit Kosovar për Garanci Kreditorë;
5. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit funksional në Projektligjin nr. 05/L-51 për treguesit gjeografikë dhe emërtimet e origjinës;

6. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryesuesja, propozoi që rendi i ditës të plotësohet edhe me këto pika të rendit të ditës:

- Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit funksional në Projektligjin nr. 05/L-52 për Energjinë termike;
- Formimi i grupit punues për Projektligjin nr. 05/L-060 për Mjekësinë Ligjore;
- Formimi i grupit punues për Projektligjin nr. 05/L-049 për administrimin e pasurisë së sekuestruar dhe të konfiskuar;
- Raportimi i kryesuesit të grupit punues për shqyrtimin e raportit me rekomandime të Avokatit të Popullit në lidhje me procedurën gjyqësore për ankesat kundër vendimeve preliminare për shpronësimin e pronës së paluajtshme, z. Agim Ademaj.

Rendi i ditës u miratua me ndryshime.

2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura më 30 tetor, 3 dhe 10 nëntor 2015

Kryesuesja konstatoi se Komisioni i miratoi procesverbalet e mbledhjeve të mbajtura më 30 tetor, 3 dhe 10 nëntor 2015, pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit funksional në Projektligjin nr. 05/L-58 për Dizajnin industrial

Kryesuesja vlerësoi se amendamenti 1 dhe 2, janë të panevojshëm, sepse rregullativa aktuale nuk e njeh: “Ministria kompetente për pronësinë industriale”, por është Agjencia e Pronësisë Industriale, në kuadër të ministrisë, pra e njëjta vlen edhe për amendamentin 2. Vlerësoi se është më e qartë të mbetet teksti i projektligjit, pasi që rregulltvoja ligjore normon gjendjen ekzistuese, dhe si e tillë, ekziston Ministria e Tregtisë dhe Industrisë. Po ashtu, rekomandoi që amendamenti 1 dhe 2, të hiqen dhe të mbetet teksti si në projektligj.

Armend Zemaj, pajtohet që amendamenti 1 dhe 2 janë të panevojshëm, pasi që në projektligj është theksuar decidivisht se cila ministri është kompetente për këtë çështje.

Pas diskutimeve, kryesuesja konstatoi se Komisioni, në mënyrë unanime, vendosi që Komisionit funksional t’ia paraqesë këtë

REKOMANDIM

1. Projektligji nr. 05/L-58 për Dizajnin industrial dhe amendamentet e propozuara, janë në pajtim me Kushtetutën dhe ligjin e zbatueshëm, përveç amendamenteve 1 dhe 2.
2. Rekomandohet që amendamenti 1 dhe 2, të hiqen dhe të mbetet teksti si në projektligj.

4. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit funksional në Projektligjin nr. 05/L-57 për themelimin e Fondit Kosovar për Garanci Kreditore

Kryesuesja tha se lidhur me raportin e Komisionit funksional **për themelimin e Fondit Kosovar për Garanci Kreditore**, kam disa vërejtje. Fillimisht, amendamenti 3, është i paqartë dhe kundërthënës, sidomos tek fjalët ku thuhet: “Në tërë tekstin e ligjit kur përdoret shprehja “Aktet nënligjore”, zëvendësohet me shprehjen: “Statuti dhe politikat e procedurave të brendshme”. Ky formulim bie në kundërshtim me pjesën e parë të amendamentit ku thuhet: “1.1 Statuti i FKGK-së, tërësia e rregullave të FKGK-së, të aprovuara nga Bordi i Drejtorëve të cilat rregullojnë funksionimin e tij, organizmin e brendshëm dhe organizimin e fondit në harmoni me këtë ligj”. Përkufizimet ndihmojnë për qartësimin e shprehjeve të përdorura në aktin normativ dhe ato duhet të jenë të qarta, duke shmangur dykuptimësitë dhe nuk ka nevojë të përkufizohen termet që janë të njohura apo janë standarde. Nocioni “aktet nënligjore”, është nocion i përgjithshëm dhe përfshin statutin, udhëzimet administrative, rregulloret, vendimet.

Statuti është akt i brendshëm dhe si i tillë përcakton funksionimin dhe organizimin e brendshëm. Nëse mbetet formulimi i propozuar, për statutin, duhet të parashihet mënyra e nxjerrjes dhe e ndryshimit, organet drejtuese, si dhe të hiqet neni 19 dhe 20 i projektligjit, pasi që mbledhjet e Bordit të Drejtorëve, nuk ka nevojë më të mbeten në nivel të ligjit, por të përfshihen me statut. Po ashtu, në nenin 3, paragrafi 1.19 dhe 1.20, në të dy paragrafët, përdoren fjalët: “Kapitali Minimal - minimumi i kapitalit që kërkohet të ketë FKGK”. Mendoj që duhet të fshihet ky formulim në paragrafin 1.19, pasi që është i përkufizuar në paragrafin 1.20.

Në nenin 16, paragrafi 4, tek çështja e anëtarëve që shërbejnë si ushtrues detyre, duhet të përcaktohet një afat kohor, pra sa kohë mund të shërbejnë si ushtrues detyre, pasi që kjo krijon hapësirë që ata të ushtrojnë funksione për kohë të gjatë.

Në nenin 16, paragrafët 15 dhe 19 të projektligjit, rekomandoi që të fuzionohen, sepse për një pozitë të tillë duhet të përcaktohet qartë konflikti i interesit. Pasi në dispozitat e projektligjit ka thirrje në Ligjin nr. 04/L-093, atëherë të harmonizohet çështja e konfliktit të interesit me dispozitat e këtij ligji. Kjo duhet të vlejë për anëtarët dhe drejtorin.

Tutje, rekomandoi të hiqet paragrafi 1.1 i nenit 18, pasi që është tërësisht i panevojshëm dhe i paqartë.

Në nenin 25, paragrafi 2 i projektligjit, rekomandohet të përcaktohet afati kohor për nxjerrjen e rregulloreve nga BQK-ja.

Doruntinë Maloku, paraqiti vërejtje në amendamentin 21, ku thuhet: “Drejtori menaxhues është i obliguar t’ia dorëzojë pasqyrat e audituara financiare të FKGK-së, Bordit të Drejtorëve, së paku 15 ditë para aprovimit të tyre”. Po ashtu, tha se nuk është relevante që çështja e finalizimit të lidhet me afate, mjafton që të ketë afat për aprovim.

Pas diskutimeve, kryesuesja konstatoi se Komisioni, në mënyrë unanime, vendosi që Komisionit funksional t'ia paraqesë këtë

REKOMANDIM

1. Projektligji nr. 05/L-57 për themelimin e Fondit Kosovar për Garanci Kreditore dhe amendamentet e propozuara, janë në pajtim me Kushtetutën dhe ligjin e zbatueshëm, përveç amendamentit 3 dhe 21, neni 3, paragrafi 1.19 dhe 1.20, neni 16, paragrafi 4,15 dhe 19, neni 18.1.1 dhe neni 25, paragrafi 2 të projektligjit.
2. Rekomandohet që amendamenti 3 dhe neni 3.1.1, të hiqet apo riformulohet. Po ashtu, neni 3, paragrafi 1.19, fjalët: “**Kapitali minimal** - minimumi i kapitalit që kërkohet të ketë FKGK”, të hiqen. Amendamenti 21, të riformulohet. Në nenin 16, paragrafi 4, të përcaktohet afati maksimal i anëtarëve që shërbejnë si ushtrues detyre, kurse paragrafët 15 dhe 19 të projektligjit, rekomandohet që të fuzionohen. Paragrafi 1.1 i nenin 18, rekomandohet të hiqet, kurse në nenin 25, paragrafi 2, të përcaktohet afati për nxjerrjen e rregulloreve nga BQK-ja.

5. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit funksional në Projektligjin nr. 05/L-51 për treguesit gjeografikë dhe për emërtimet e origjinës

Kryesuesja tha se vërejtje të njëjta ka edhe në raportin e Komisionit funksional në Projektligjin për treguesit gjeografikë dhe për emërtimet e origjinës. Amendamenti 1 dhe 2, janë të panevojshëm, sepse rregullativa aktuale, nuk njeh: “Ministria kompetente për emërtime të origjinës dhe treguesve gjeografikë”, por është Agjencia e Pronësisë Industriale, në kuadër të ministrisë, e njëjta vlen edhe për amendamentin 2. Pra, vlerësoi se është më e qartë të mbetet teksti i projektligjit.

Meqë nuk kishte vërejtje tjera, kryesuesja konstatoi se Komisioni, në mënyrë unanime, vendosi që Komisionit funksional t'ia paraqesë këtë

REKOMANDIM

1. Projektligji nr. 05/L-51 për treguesit gjeografikë dhe për emërtimet e origjinës dhe amendamentet e propozuara, janë në pajtim me Kushtetutën dhe ligjin e zbatueshëm, përveç amendamenteve 1 dhe 2.
2. Rekomandohet që amendamenti 1 dhe 2, të hiqen dhe të mbetet teksti si në projektligj.

6. Të ndryshme

a. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit funksional në Projektligjin nr. 05/L-52 për Energjinë termike

Kryesuesja paraqiti për shqyrtim raportin me amendamente të Komisionit funksional në Projektligjin nr. 05/L-52 për Energjinë termike dhe kërkoi nga anëtarët që të deklarohen, nëse kanë vërejtje.

Meqë nuk kishte vërejtje, kryesuesja konstatoi se Komisioni, në mënyrë unanime, vendosi që Komisionit funksional t'ia paraqesë këtë

REKOMANDIM

1. Projektligji nr. 05/L-52 për Energjinë termike dhe amendamentet e propozuara, janë në pajtim me Kushtetutën dhe ligjin e zbatueshëm.
2. Projektligji dhe amendamentet e propozuara mund t'i procedohen Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

b. Formimi i grupit punues për Projektligjin nr. 05/L-060 për Mjekësinë Ligjore

Komisioni për shqyrtimin e Projektligjit nr. 05/L-060 për Mjekësinë Ligjore, formoi grupin punues në përbërje:

Selvije Halimi - kryesuese,
Nezir Çoçaj - anëtar,
Doruntinë Maloku – anëtare, dhe
Milena Miliçeviq – anëtare.

c. Formimi i grupit punues për Projektligjin nr. 05/L-049 për administrimin e pasurisë së sekuestruar dhe të konfiskuar

Komisioni për shqyrtimin e Projektligjit nr. 05/L-049 për administrimin e pasurisë së sekuestruar dhe të konfiskuar formoi grupin punues në përbërje:

Agim Ademaj - kryesues,
Agim Aliu - anëtar, dhe
Danush Ademi - anëtar.

d. Raportimi i kryesuesit të grupit punues për shqyrtimin e raportit me rekomandime të Avokatit të Popullit në lidhje me procedurën gjyqësore për ankesat kundër vendimeve preliminare për shpronësimin e pronës së paluajtshme, z. Agim Ademaj.

Agim Ademaj, në cilësinë e kryesuesit të grupit punues për shqyrtimin e raportit me rekomandime të Avokatit të Popullit, në lidhje me procedurën gjyqësore për ankesat kundër vendimeve preliminare për shpronësimin e pronës së paluajtshme, tha se më 26.11.2015, kemi mbajtur një takim të grupit, ku kemi pasur prezent Avokatin e Popullit, z. Hilmi Jashari, i cili arsyetoi raportin me rekomandime. Të pranishëm ishin edhe përfaqësues nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, Ministria e Financave dhe Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor. Nga përfaqësuesit e ministrive nuk dëgjua argumente nëse qëndrojnë apo jo pretendimet e Avokatit të Popullit, me përjashtim të përfaqësuesit nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, i cili tha se ligji ka nevojë të ndryshohet në disa pjesë dhe ka disa lëvizje në këtë drejtim, që kemi bërë si ministri. Si grup punues, kemi vlerësuar se kjo çështje duhet adresuar te Komisioni funksional, në këtë rast, tek Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Mjedis e Planifikim Hapësinor, pasi

që u njoftuam nga përfaqësuesi nga Ministria e Mjedisit se Departamenti i Shpronësimit, ka kaluar në këtë ministri. Propozoj që t'ia dërgojmë këtë rekomandim Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Mjedis e Planifikim Hapësinor.

- I. Të shqyrtohet raporti me rekomandime i Avokatit të Popullit në lidhje me procedurën gjyqësore për ankesat kundër vendimeve preliminare për shpronësimin e pronës së paluajtshme.
- II. Komisioni, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, të koordinohen, që me rastin e përgatitjes së programit legjislativ për vitin 2016, të merret nisma për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-139 për shpronësimin e pronës së paluajtshme, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 03/L-205, qoftë nga Ministria apo nga Komisioni.

Kopje t'i dërgohet Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, Ministrisë së Financave dhe Zyrës së Kryeministrit.

Mbledhja përfundoi në orën 11:35.

E përgatiti:

Stafi Mbështetës i Komisionit.

Nënkryetarja e Komisionit,

Selvije Halimi